



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Departamenti i Specialiteteve Tekniko Mjekësore, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, (FSHMT) shpall konkurs për 5 (pesë) personel akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2024 – 2025, sipas kategorive:

I. 4 (katët) kandidatë të kategorisë asistentlektor,

II. 1 (një) kandidat të kategorisë lektor

I. Kriteria të përgjithshme e të veçanta të kategorisë asistentlektor.

I.1 Kriteret të përgjithshme për kandidatët e kategorisë *asistentlektor* janë si më poshtë:

1. Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet universitare Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të, brenda ose jashtë vendit në fushën e Shkencave Mjekësore/Mjekësi e përgjithshme/Infermieri e përgjithshme dhe Teknik imazherie me notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Kandidati duhet të njohë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore.
3. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
4. Kandidati të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
5. Të jetë i aftë për punë.

I.2. Kriteret të veçanta për kandidatët e kategorisë *asistentlektor* janë si më poshtë:

1. Preferohet të ketë përvojë në profesion;
2. Preferohet të jetë i përfshirë në botime shkencore në organe kombëtare/ndërkombëtare në fushën e kërkuar;
3. Preferohet të ketë përvojë mësimdhënie në IAL;
4. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

II. Kriteria të përgjithshme e të veçanta të kategorisë lektor.

II.1 Kriteret të përgjithshme për kandidatët e kategorisë *lektor* janë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

1. Kandidati duhet të ketë gradën Doktor në fushën e mjekësisë. Grada e fituar jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të, brenda ose jashtë vendit në fushën e Mjekësisë së përgjithsme me notë mesatare të studimeve mbi 8. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS;
3. Kandidati duhet të ketë të paktën 2(dy) vite punë mësimdhënie në IAL;
4. Kandidati duhet të njohë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore;
5. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
6. Kandidati të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
7. Të jetë i aftë për punë.

II.2. Kriteret të veçanta për kandidatit e kategorisë *lektor* janë si më poshtë:

1. Kandidati të ketë përvojë punë/specializime në fushën e mjekësisë
2. Preferohet të jetë i përfshirë në kumtesa/botime shkencore në organe kombëtare/ndërkombëtare në fushën e kërkuar;
3. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë, në rrugë postare protokollin e në Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).
3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

7. Raport i aftësisë për punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetsore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (23.01.2025 - 03.02.2025) nga data e shpalljes në www.unie.edu.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *Personel akademik, Departamenti i
Lëndëve paraklinike*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht nga Komisioni për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës.